



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.164/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Valdete Daka dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit B. K. nga fshati M., komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me nenin 275 par.1, nënpar.1.8 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.26/2023 të datës 29.05.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.424/2023, të datës 02.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13 mars 2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B. K., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.26/2023 të datës 29.05.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.424/2023, të datës 02.10.2023.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.26/2023 të datës 29.05.2023, i dënuari B. K. është shpall fajtor për veprën penale posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2, lidhur me nenin 275 par.1 nënpar.1.8 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej ... (...) viti e ... (...) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumën prej ... (...) euro, të cilat dënime do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobën, atëherë i njëjti dënim do ti zëvendësohet me dënim me burg duke i llogaritur 1 (një) ditë burgimi për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës. Të dënuarit i

konfiskohet substanca narkotike në peshë prej ... gramëve e cila gjendet në ruajtje në zinxhirin policor me numër ... dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e njëjta do të shkatërrohet. Është obliguar i dënuari që t'i paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej ... (...) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PAKR.nr.424/2023, të datës 02.10.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit B. K., avokati Xh. A. nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënpar.1.10 dhe shkeljeve tjera të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 të KPP-së, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që t'i ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara ashtu që të dënuarit t'i shqiptojë një dënim shumë më të butë nga ai që i është shqiptuar, ose aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulojë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.96/2024, e datës 11.03.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit B. K., av. Xh. A., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoj shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, par.1 lidhur me nenin 436, par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësoj pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë marrë me shkelje të nenit 384, par.1 nënpar.1.3 dhe par.2, nënpar.2.1, lidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së, sepse nuk kanë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh të dënuarit i shqipton një dënim kaq të lartë me burgim. Mbrojtja po ashtu ka shtuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal nuk e ka çmuar pranimin e fajësisë dhe bashkëpunimin e të dënuarit me hetuesit e policisë gjykatën dhe prokurorinë për ndriçimin e tërësishëm të veprës penale. Ka theksuar se dënimi i shqiptuar është tejet i lartë sepse për të dënuarin ka pasur rrethana posaçërisht lehtësuese për ti shqiptuar një dënim më të butë e me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit, andaj mbrojtja konsideron se gjykata nuk i ka zbatuar drejt dispozitat ligjore për matjen e dënimit nga neni 73 të KPRK ku parashihen rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se pretendimet e mbrojtëses të dënuarit janë të papazuara, për faktin se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me shkelje të ligjit penal.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme fillimisht të theksoj faktin se i dënuari në shqyrtimin fillestar e ka bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë ishte aprovuar. Me këtë rast duhet theksuar fakti se pranimi i fajësisë në asnjë rrethanë nuk prejjudikon caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, por e rëndësishme është që i dënuari ka qenë i njoftuar përkitazi me veprën penale, natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ndërsa i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe atë në prezencë të mbrojtësit të tij.

Siç është theksuar edhe më parë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljes së ligjit penal lidhur me dënimin e shqiptuar. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar në suaza të dispozitës së nenit 269 par.2 lidhur me nenin 275 par.1 nënpar.1.8 të KPRK-së.

Në faqen e 4-të të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë theksuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit e po ashtu edhe janë renditur rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese të cilat janë marrë për bazë lidhur me shqiptimin e dënimit, duke i shqiptuar të dënuarit dënim nën minimumin e paraparë ligjor (minimumi i posaçëm).

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, par.5 të KPP-së, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkuluar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Përndryshe, duhet theksuar faktin se nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkuluar kompetencat ligjore dhe se në rastin konkret duke u zbatuar dispozitat e zbutjes së dënimit, të dënuarit B. K. i është shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë me ligj (minimumin e posaçëm), kështu që edhe pretendimet e mbrojtësit të tij në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Nga të gjitha këto që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 437 të KPP-së.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.164/2024, më 13 mars 2024

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Agim Maliqi